



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI

**LIGJ**

**Nr. 66/2021**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN  
E VITIT 1988 NË LIDHJE ME KONVENTËN NDËRKOMBËTARE  
PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin e vitit 1988 në lidhje me Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

**Gramoz RUÇI**

Miratuar në datën 20.5.2021

# PROTOKOLL I VITIT 1988 NË LIDHJE ME KONVENTËN NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974

## **PALËT E KËTIJ PROTOKOLLI,**

**DUKE QENË PALË** të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, të nënshkruar në Londër më 1 nëntor 1974,

**DUKE PRANUAR** nevojën për prezantimin në Konventën e lartpërmendur të dispozitave për vrojtimin dhe certifikimin në përputhje me dispozitat përkatëse në instrumentet e tjera ndërkombëtare,

**DUKE PASUR PARASYSH** se kjo nevojë mund të plotësohet më mirë me anë të nënshkrimit të një Protokollit në lidhje me Konventën Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, të vitit 1974,

**KANË RËNË DAKORD** si më poshtë:

## **Neni I**

### **Detyrimet e përgjithshme**

1 Palët e këtij Protokollit marrin përsipër të zbatojnë dispozitat e këtij Protokollit dhe Shtojcë së tij, të cilat janë pjesë përbërëse e këtij Protokollit. Çdo referencë ndaj këtij Protokollit përbën gjithashtu referencë ndaj Shtojcës së tij.

2 Si ndërmjet Palëve të këtij Protokollit, dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det të vitit 1974, të ndryshuar, (në vijim e referuar si "Konventa"), do të zbatohen në bazë të ndryshimeve dhe shtesave të përcaktuara në këtë Protokoll.

3 Në lidhje me anijet që kanë të drejtë të mbajnë flamurin e një Shteti i cili nuk është Palë e Konventës dhe këtij Protokollit, Palët e këtij Protokollit zbatojnë kërkesat e Konventës dhe këtij Protokollit sipas nevojës, për të siguruar që të mos i jepet trajtim më i favorshëm këtyre anijeve.

## **Neni II**

### **Traktatet e mëparshme**

1 Si ndërmjet Palëve të këtij Protokollit, ky Protokoll zëvendëson dhe shfuqizon Protokollin e vitit 1978 që lidhet me Konventën.

2 Pavarësisht dispozitave të tjera të këtij Protokollit, çdo çertifikatë e lëshuar nën dhe në përputhje me dispozitat e Konventës dhe çdo shtesë në këtë çertifikatë të lëshuar nën dhe në përputhje me dispozitat e Protokollit të vitit 1978 në lidhje me Konventën e cila është në fuqi në momentin kur ky Protokoll hyn në fuqi për Palën e cila ka lëshuar çertifikatën ose shtesën e saj, do të mbetet e vlefshme derisa t'i përfundojë afati sipas kushteve të Konventës ose Protokollit të vitit 1978 që lidhet me Konventën, sipas rastit.

3 Palët e këtij Protokollit nuk do të lëshojnë çertifikata në bazë të dhe sipas dispozitave të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, të miratuar më 1 nëntor 1974.

## **Neni III**

### **Komunikimi i informacionit**

Palët e këtij Protokollit angazhohen të komunikojnë dhe depozitojnë pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare Detare (në vijim e referuar si "Organizata"):

- (a) tekstin e ligjeve, dekreteve, urdhrave, rregulloreve dhe instrumenteve të tjera që janë shpallur për çështje të ndryshme brenda fushës së këtij Protokollit;
- (b) listën e vrojtuesve të emëruar ose organizatave të autorizuara për të vepruar në emrin e tyre në administrimin e masave për sigurinë e jetës në det për dijeni të zyrtarëve të Palëve dhe një njoftim për përgjegjësitë dhe kushtet specifike të autoritetit të deleguar për ata vrojtues të emëruar apo organizata të njohura; dhe
- (c) një numër të mjaftueshëm specimenesh të çertifikatave të tyre të lëshuara sipas

parashikimeve të këtij Protokollit.

#### Neni IV

##### **Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi**

1 Ky Protokoll është i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës nga data 1 mars 1989 deri më 28 shkurt 1990 dhe pas kësaj do të mbetet i hapur për aderim. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar ligjërisht këtij Protokollit me anë të një:

- (a) nënshkrimi pa rezervë në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin; ose
- (b) nënshkrimi që i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, i ndjekur nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose
- (c) aderimi.

2 Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi kryhet me depozitimin e një instrumenti për atë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës.

3 Ky Protokoll mund të nënshkruhet pa rezervë, të ratifikohet, pranohet, miratohet ose aderohet vetëm nga Shtetet që kanë nënshkruar pa rezervë, ratifikuar, pranuar, miratuar ose aderuar në Konventë.

#### Neni V

##### **Hyrja në fuqi**

1 Ky Protokoll hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën janë përmbushur të dy kushtet e mëposhtme:

- (a) jo më pak se pesëmbëdhjetë shtete, flotat e kombinuara tregtare të të cilave përbëjnë jo më pak se pesëdhjetë për qind të tonazhit bruto të anijeve tregtare të botës, kanë shprehur pëlqimin e tyre për t'iu nënshtruar ligjërisht atij në përputhje me nenin IV, dhe
- (b) janë plotësuar kushtet për hyrjen në fuqi të Protokollit të vitit 1988 në lidhje me Konventën Ndërkombëtare të Linjave të Ngarkesave të vitit 1966, me kusht që ky Protokoll të mos hyjë në fuqi para datës 1 shkurt 1992.

2 Për shtetet që kanë depozituar një instrument të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në lidhje me këtë Protokoll pasi të jenë përmbushur kushtet për hyrjen e tij në fuqi, por përpara datës së hyrjes në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi hyn në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollit ose tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit, cilado qoftë data më e vonshme.

3 Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit i depozituar pas datës në të cilën hyn në fuqi ky Protokoll, do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit.

4 Pas datës kur një ndryshim i këtij Protokollit konsiderohet të jetë pranuar sipas nenit VI, çdo instrument ratifikimi, pranimi, miratimi apo aderimi i depozituar do të zbatohet për këtë Protokoll, të ndryshuar.

#### Neni VI

##### **Ndryshimet**

Procedurat e përcaktuara në nenin VIII të Konventës do të zbatohen edhe për ndryshimet e bëra në këtë Protokoll, me kusht që:

- (a) referencat në atë nen të Konventës dhe Qeveritë Kontraktuese do të konsiderohen të nënkuptojnë përkatësisht referenca ndaj këtij Protokollit dhe Palëve të këtij Protokollit;
- (b) ndryshimet në nenet e këtij Protokollit dhe në Aneks do të miratohen dhe hyjnë në fuqi në përputhje me procedurën e zbatueshme për ndryshimet e neneve të Konventës ose në Kapitullin I të Aneksit të saj; dhe
- (c) ndryshimet në shtojcën e Aneksit të këtij Protokollit mund të miratohen dhe hyjnë fuqi në përputhje me procedurën e zbatueshme për ndryshimet në Aneksin e Konventës, të ndryshëm nga Kapitulli I.

#### Neni VII

##### **Denoncimi**

1 Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo Palë në çdo kohë pas përfundimit të afatit prej

pesë vjetësh

nga data kur ky Protokoll hyn në fuqi për atë Palë.

2 Denoncimi hyn në fuqi me depozitimin e një instrumenti denoncimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës

3 Një denoncim hyn në fuqi një vit ose në një periudhë më të gjatë siç mund të specifikohet në instrumentin e denoncimit, pas marrjes së tij nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës.

4 Denoncimi i Konventës nga njëra nga Palët konsiderohet si denoncim i këtij Protokoll nga ajo Palë. Ky denoncim do të hyjë në fuqi në të njëjtën datë me denoncimin e Konventës, sipas paragrafit (c) të nenit XI të Konventës.

### **Neni VIII**

#### **Depozitari**

1. Ky Protokoll depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës (në vijim i referuar si "depozitari").

2. Depozitari:

(a) informon Qeveritë e të gjitha Shteteve që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të për:

(i) çdo nënshkrim ose depozitim të ri të një instrumenti të ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit, së bashku me datën e tij;

(ii) datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll;

(iii) depozitimin e çdo instrumenti të denoncimit të këtij Protokoll, së bashku me datën kur është marrë dhe datën kur denoncimi hyn në fuqi;

(b) i përcjell kopjet e vërtetuara me origjinalin të të këtij Protokoll Qeverive të të gjitha Shteteve që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose që kanë aderuar në të.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij Protokoll, një kopje origjinale e tij e vërtetuar me origjinalin do t'i përcillet nga depozitari Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

### **Neni IX**

#### **Gjuhët**

Ky Protokoll është hartuar në një dokument të vetëm origjinal në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëllë autentiq. Përkthimi zyrtar në gjuhën italiane do të përgatitet dhe depozitohet me origjinalin e nënshkruar.

**NËNSHKRUAR NË LONDËR** më njëmbëdhjetë nëntor një mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë.

**NË DËSHMI SA MË SIPËR**, të nënshkruarit, të autorizuar sipas rregullave nga Qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll.

[Nënshkrimet nuk janë riprodhuar këtu]

## ANEKS

NDRYSHIMET DHE SHITESAT NË ANEKSIN E KONVENTËS NDËRKOMBËTARE  
PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974KREU I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

## PJESA A – ZBATIMI, PËRKUFIZIME ETJ.

**Rregullorja 2**  
**Përkufizime**

Teksti ekzistues i paragrafit (k) zëvendësohet me sa vijon:

(k) Anije e re nënkupton anijet kili i të cilave është vendosur tashmë ose që është në një fazë të përafërt ndërtimi më ose pas datës 25 maj 1980.

Paragrafi vijues i shtohet tekstit ekzistues:

(n) "Datë përvjetori" nënkupton ditën dhe muajin e çdo viti që do të përkojë me datën e skadimit të çertifikatës.

## PJESA B - VROJTIMET DHE ÇERTIFIKATAT

**Rregullorja 6**  
**Inspektimi dhe vrojtimi**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

(a) Inspektimi dhe vrojtimi i anijeve, për sa i përket zbatimit të dispozitave të këtyre rregulloreve dhe dhënies së përjashtimeve sipas saj, do të kryhen nga zyrtarët e Administratës. Megjithatë, Administrata mund t'ua besojë inspektimet dhe vrojtimet ose vrojtuesve të emëruar për atë qëllim, ose organizatave të njohura prej saj.

(b) Administrata që cakton vrojtues ose njeh organizata për kryerjen e inspektimeve dhe vrojtimeve siç është përcaktuar në paragrafin (a), duhet të paktën të autorizojë çdo vrojtues të emëruar ose organizatë të njohur për:

(i) të kërkuar riparimet e anijes;

(ii) të kryer inspektimet dhe vrojtimet, nëse kërkohen nga autoritetet përkatëse nga një shtet Port.

Administrata do të njoftojë Organizatën për përgjegjësitë dhe kushtet specifike të autoritetit të deleguar për ata vrojtues të emëruar apo organizata të njohura.

(c) Kur një vrojtues i emëruar ose një organizatë e njohur përcakton se gjendja e anijes ose pajisjeve të saj nuk përkon kryesisht me të dhënat e çertifikatës ose është e tillë që anija nuk është e përshtatshme për të lundruar në det pa sjellë rrezik për anijen apo personat në bord, vrojtuesi ose organizata duhet menjëherë të sigurojnë marrjen e masave korrigjuese dhe të njoftojnë Administratën në kohën e duhur. Nëse nuk ndërmerren masa korrigjuese, çertifikata përkatëse duhet të tërhiqet dhe Administrata duhet të njoftohet menjëherë; dhe, nëse anija ndodhet në portin e një Pale tjetër, autoritetet përkatëse të Shtetit port duhet të njoftohen gjithashtu menjëherë. Në rastet kur një zyrtar i administratës, vrojtues i emëruar apo organizatë e njohur ka njoftuar autoritetet përkatëse të Shtetit port, Qeveria e Shtetit port përkatës duhet t'i japë atyre ndihmën e nevojshme për të kryer detyrimet e tyre sipas kësaj rregulloreje. Sipas rastit, Qeveria e Shtetit port në fjalë duhet të sigurojë që anija nuk do të lundrojë derisa të jetë në gjendjen e duhur apo të largohet nga porti me qëllim për të proceduar drejt një kantieri të përshtatshëm riparimi, pa sjellë rrezik për anijen apo personat në bord.

(d) Në çdo rast, Administrata duhet të garantojë një inspektim dhe vrojtim të plotë dhe efektiv të anijes dhe duhet të marrë masat e nevojshme për të përmbushur këtë detyrim.

**Rregullorja 7**

**Vrojtimet e anijeve të pasagjerëve**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

- (a) Anija e pasagjerëve i nënshtrohet vrojtimeve të specifikuara më poshtë:
- (i) një vrotim fillestar përpara se anija të vihet në shërbim;
  - (ii) vrotim përsëritës një herë në 12 muaj, përveç kur zbatohen rregulloret 14 (b), (e), (f) dhe (g);
  - (iii) vrojtime shtesë, sipas rastit.
- (b) Vrojtimet e referuara më lart do të kryhen si më poshtë:
- (i) vrotimi fillestar përfshin inspektimin e plotë të strukturës, makinerive dhe pajisjeve të anijes, përfshirë pjesën e jashtme të pjesës fundore të anijes dhe brenda dhe jashtë bojlerëve. Ky vrotim duhet të jetë i tillë që të sigurojë që rregullimet, materialet dhe trarët e strukturës, bojlerët dhe enët e tjera të presionit dhe pajisjet e tyre, makineritë kryesore dhe ndihmëse, instalimet elektrike, instalimet radio, përfshirë ato të përdorura në pajisjet për shpëtimin e jetës, mbrojtjen nga zjarri, sistemet dhe pajisjet e sigurisë nga zjarri, pajisjet dhe rregullimet për shpëtimin e jetës, pajisjet e lundrimit të anijes, botimet për lundrimin, mjetet e imbarkimit për drejtuesit e anijes dhe pajisjet e tjera të jenë plotësisht në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje, dhe të ligjeve, dekretëve, urdhrave dhe rregulloreve të nxjerra në zbatim të tyre nga Administrata për anijet dhe shërbimet për të cilat janë programuar. Vrotimi duhet gjithashtu të sigurojë që funksionimi i të gjitha pjesëve dhe pajisjeve të anijes të jetë në të gjitha aspektet i kënaqshëm dhe që anija të jetë e pajisur me dritat, format, mjetet për të lëshuar sinjale tingulli dhe sinjale alarmi siç kërkohet nga dispozitat e kësaj rregulloreje dhe Rregulloret e zbatueshme Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det i;
  - (ii) Vrojtimet e përsëritura duhet të sigurojnë inspektimin e strukturës, bojlerëve dhe enëve të tjera të presionit, makineritë dhe pajisjet, përfshirë pjesën e jashtme të fundit të anijes. Vrotimi duhet të jetë i tillë që të sigurojë që anija, për sa i përket strukturës, bojlerëve dhe enëve të tjera të presionit dhe pajisjet e tyre, makinerive kryesore dhe ndihmëse, instalimeve elektrike, instalimeve radio, përfshirë ato që përdoren në pajisjet për shpëtimin e jetës, sistemeve dhe pajisjeve për mbrojtjen nga zjarri dhe sigurinë nga zjarri, pajisjeve dhe rregullimeve për shpëtimin e jetës, pajisjeve për lundrimin e anijeve, botimeve detare, mjeteve të imbarkimit për drejtuesit e anijes dhe pajisjeve të tjera, të jenë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin janë synuar dhe në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe ligjet, dekretet, urdhrat dhe rregulloret e nxjerra në zbatim të tyre nga Administrata. Dritat, format dhe mjetet për të lëshuar sinjale zanore dhe sinjale alarmi të anijes gjithashtu do t'i nënshtrohen këtij lloj vrotimi, me qëllim garantimin se janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe të Rregulloret e zbatueshme Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det në fuqi;
  - (iii) një vrotim shtesë, qoftë i përgjithshëm apo i pjesshëm, sipas rrethanave, do të kryhet pas një riparimi që rezulton nga hetimet e përcaktuara në rregulloren 11 ose sa herë që bëhen riparime ose rinovime thelbësore. Vrotimi duhet të jetë i tillë që të sigurojë që riparimet apo rinovime e nevojshme janë bërë në mënyrë efektive, që materiali dhe mjeshtëria e përdorur për to janë në të gjitha aspektet të kënaqshme dhe se anija përputhet në të gjitha aspektet me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe të Rregulloreve Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det në fuqi, si dhe të ligjeve, dekretëve, urdhrave dhe rregulloreve të nxjerra në zbatim të tyre nga Administrata;
- (c) (i) ligjet, dekretet, urdhrat dhe rregulloret e përmendura në paragrafin (b) të kësaj rregulloreje duhet të jenë, në të gjitha drejtimet të tilla që të sigurojnë që anija, nga pikëpamja e sigurisë së jetës, të jetë e përshtatshme për shërbimin për të cilat është synuar;
- (ii) ata, përveç të tjerash, përcaktojnë kërkesat që duhen respektuar gjatë testimeve fillestare dhe pasuese hidraulike apo testimeve të tjera alternative të pranueshme,

të cilat do të kryhen për bojlerët kryesorë dhe ndihmës, lidhjet, tubat e avullit, marrësit me presion të lartë dhe rezervuarët e karburantit për motorët me djegie të brendshme, duke përfshirë procedurat e testimit që duhen ndjekur dhe intervalet midis dy testeve të njëpasnjëshme.

### **Rregullorja 8**

#### **Vrojtimet e pajisjeve për shpëtimin e jetës dhe pajisjeve të tjera të anijeve të mallrave**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

- (a) Pajisjet për shpëtimin e jetës dhe pajisjet e tjera të anijeve të mallrave me tonazh bruto 500 ose më shumë, të referuara në paragrafin (b)(i), i nënshtrohen vrojtimeve të specifikuara si më poshtë:
- (i) Vrojtimit fillestar përpara se anija të vihet në shërbim;
  - (ii) Vrojtimit përsëritur në intervalet e specifikuara nga Administrata, por pa tejkaluar 5 vjet, përveç rasteve kur zbatohet rregullorja 14 (b), (e), (f) dhe (g);
  - (iii) Vrojtimit periodik brenda tre muajve para ose pas datës së përvjetorit të dytë ose brenda tre muajve para ose pas datës së përvjetorit të tretë të Çertifikatës së Pajisjeve të Sigurisë së Anijeve të Mallrave, të cilat do të kryhen në vend të njërit prej vrojtimeve vjetore të përcaktuar në paragrafin (a)(iv) ;
  - (iv) Vrojtimit vjetor brenda 3 muajve para ose pas datës së çdo përvjetori të Çertifikatës së Pajisjeve të Sigurisë së Anijeve të Mallrave.
  - (v) Vrojtimit shtesë i përcaktuar për anijet e pasagjerëve në rregulloren 7 (b) (iii).
- (b) Vrojtimet e përmendura në paragrafin (a) do të kryhen si më poshtë:
- (i) Vrojtimit fillestar duhet të realizojë inspektimin e plotë të sistemeve dhe pajisjeve të sigurisë nga zjarri, pajisjeve dhe rregullimeve për shpëtimin e jetës, përveç instalimeve radio, pajisjeve për lundrimin e anijes, mjeteve të imbarkimit të drejtuesve të anijes dhe pajisjeve të tjera, për të cilat zbatohen kapitujt II-1, II-2, III dhe V, për të siguruar që ato përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje, janë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin anija është synuar. Planet e kontrollit të zjarrit, botimet detare, dritat, format, mjetet për lëshimin e sinjaleve zanore dhe sinjaleve të alarmit gjithashtu duhet t'i nënshtrohen vrojtimet të lartpërmendur për të garantuar që përputhen me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe, sipas rastit, Rregulloret Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det në fuqi;
  - (ii) Vrojtimit i përsëritur dhe periodik duhet të realizojë inspektimin e pajisjeve të përmendura në paragrafin (b)(i), për të siguruar që përputhet me kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje dhe Rregulloret Ndërkombëtare për Parandalimin e Përplasjeve në Det në fuqi, janë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin anija është synuar.
  - (iii) Vrojtimit vjetor duhet të realizojë një inspektim të përgjithshëm të pajisjeve të përmendura në paragrafin (b) (i) për të siguruar që është mirëmbajtur në përputhje me rregulloren 11(a) dhe është në gjendje të kënaqshme për shërbimin për të cilin anija është synuar.
- (c) Vrojtimet periodike dhe vjetore të përmendura në paragrafët (a)(iii) dhe (a)(iv) duhet të jenë të miratuara në Çertifikatën e Pajisjeve të Sigurisë së Anijeve të Mallrave.

### **Rregullorja 9**

#### **Vrojtimet e instalimeve radio dhe radare të anijeve të mallrave**

Titulli ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

“Vrojtimet e instalimeve radio të anijeve të mallrave”

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

- (a) Instalimet radio, përfshirë ato të përdorura në pajisjet për shpëtimin e jetës, të anijeve të mallrave për të cilat duhet të zbatohen kapitujt III dhe IV, duhet t'i nënshtrohen vrojtimeve të mëposhtme:

- (i) vrojtime fillestar përpara se anija të vihet në shërbim;
  - (ii) vrojtime të përsëritura në intervalet e specifikuara nga Administrata, por jo më larg se 5 vjet, përveç rasteve kur zbatohet rregullorja 14(b), (e), (f) dhe (g);
  - (iii) vrojtime periodike brenda tre muajve para ose pas datës së çdo përvjetori të Çertifikatës së Radios të Sigurisë së Anijeve të Mallrave.
  - (iv) vrojtime shtesë siç përcaktohen për anijet e pasagjerëve në rregulloren 7(b)(iii).
- (b) Vrojtimit e përmendura në paragrafin (a) do të kryhen si më poshtë:
- (i) vrojtimit fillestare do të realizojnë një inspektim të plotë të instalimeve radio të anijeve të mallrave, përfshirë ato të përdorura në pajisjet për shpëtimin e jetës, për të garantuar që ato janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
  - (ii) vrojtimit e përsëritura dhe periodike do të realizojnë një inspektim të instalimeve radio të anijeve të mallrave, përfshirë ato të përdorura në pajisjet për shpëtimin e jetës, për të garantuar që janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje;
- (c) vrojtimit periodike të përmendura në paragrafët (a)(iii) duhet të miratohen në Çertifikatën e Radios të Sigurisë së Anijeve të Mallrave.

### **Rregullorja 10**

#### **Vrojtimit e trupit të anijes, makinerive dhe pajisjeve të anijeve të mallrave**

Titulli ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

“Vrojtimit e strukturës, i makinerive dhe pajisjeve të anijeve të mallrave

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

(a) Struktura, makineritë dhe pajisjet (përveç atyre për të cilat janë lëshuar një Çertifikatë Pajisjesh për Sigurinë e Anijeve të Mallrave dhe një Çertifikatë e Radios për Sigurinë e Anijeve të Mallrave) e një anije mallrash, siç përcaktohet në paragrafin (b)(i), i nënshtrohen vrojtimeve dhe inspektimeve si më poshtë:

- (i) vrojtime fillestare, përfshirë inspektimin e pjesës së jashtme të fundit të anijes, përpara se ajo të vihet në shërbim;
  - (ii) vrojtime të përsëritura në intervalet e specifikuara nga Administrata, por jo më larg se 5 vjet, përveç rasteve kur zbatohet rregullorja 14(b), (e), (f) dhe (g);
  - (iii) vrojtime të ndërmjetme brenda tre muajve para ose pas datës së përvjetorit të dytë ose brenda tre muajve para ose pas datës së përvjetorit të tretë të Çertifikatës së Ndërtimit për Sigurinë e Anijeve të Mallrave, të cilat do të kryhen në vend të njërit prej vrojtimeve vjetore të përcaktuar në paragrafin (a)(iv);
  - (iv) vrojtime vjetore brenda 3 muajve para ose pas çdo date përvjetori të Çertifikatës së Ndërtimit për Sigurinë e Anijeve të Mallrave;
  - (v) të paktën dy inspektime të pjesës së jashtme të fundit të anijes gjatë çdo periudhe pesë vjeçare, përveç rasteve kur zbatohet rregullorja 14(e) ose (f). Kur zbatohet rregullorja 14(e) ose (f), periudha pesë vjeçare mund të zgjatet që të përkojë me periudhën e zgjatur të vlefshmërisë së çertifikatës. Në të gjitha rastet, intervali midis dy inspektimeve të tilla nuk duhet të kalojë 36 muaj;
  - (vi) vrojtime shtesë siç përcaktohet për anijet e pasagjerëve në rregulloren 7(b)(iii).
- (b) Vrojtimit dhe inspektimit e përmendura në paragrafin (a) do të kryhen si më poshtë:
- (i) gjatë vrojtimeve fillestare do të kryhet inspektimi i plotë i strukturës, makinerive dhe pajisjeve. Këto vrojtime duhet të sigurojnë që rregullimet, materialet, trarët dhe mjeshhtëria e strukturës, bojlerët dhe enët e tjera të presionit, pajisjet e tyre, makineritë kryesore dhe ndihmëse, përfshirë ingranazhet drejtuese dhe sistemet e tyre të kontrollit, instalimet elektrike dhe pajisjet e tjera, janë në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje dhe në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin anija është projektuar dhe janë siguruar të dhënat mbi qëndrueshmërinë. Në rastin e cisternave, vrojtimit duhet gjithashtu të realizojnë inspektimin e dhomave të pompave, mallrave, depos së karburantit dhe sistemeve të tubacioneve të ajrimit dhe pajisjeve të sigurisë të lidhura me to;
  - (ii) vrojtimit përsëritëse duhet të realizojnë inspektimin e strukturës, makinerisë dhe pajisjeve të përmendura në paragrafin (b)(i), për të siguruar që janë në përputhje me



- kërkesat përkatëse të kësaj rregulloreje, janë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin është projektuar anija.
- (iii) vrojtimit e ndërmjetme duhet të realizojnë inspektimin e strukturës, bojlerëve dhe enëve të tjera të presionit, makinerive dhe pajisjeve, ingranazheve drejtuese dhe sistemeve të tyre të kontrollit dhe instalimeve elektrike, për të siguruar që janë në gjendje të kënaqshme për shërbimin për të cilin është projektuar anija. Në rastin e cisternave, vrojtimit duhet gjithashtu të realizojnë inspektimin e dhomave të pompave, mallrave, depos së karburantit dhe sistemeve të tubacioneve të ajrimit dhe pajisjeve të sigurisë të lidhura me to dhe testimin e rezistencës së izoluesit të instalimeve elektrike në zonat me rrezik;
- (iv) vrojtimit vjetore duhet të realizojnë inspektimin e përgjithshëm të strukturës, makinerive dhe pajisjeve të përmendura në paragrafin (b)(i), për të siguruar që ato janë mirëmbajtur në përputhje me rregulloren 11(a) dhe janë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin është projektuar anija;
- (v) inspektimi i pjesës së jashtme të fundit të anijes dhe vrojtimi i njësive të lidhura me të, të inspektuara në të njëjtën kohë, duhet të jetë i atillë që të sigurojë që ato janë në gjendje të kënaqshme dhe të përshtatshme për shërbimin për të cilin është projektuar anija.
- (c) vrojtimit e ndërmjetme dhe vjetore dhe inspektimet e pjesës së jashtme të fundit të anijes të përmendur në paragrafët (a)(iii), (a)(iv) dhe (a)(v), duhet të miratohen në Çertifikatën e Ndërtimit për Sigurinë e Anijeve të Mallrave.

### **Rregullorja 11**

#### **Ruajtja e gjendjes pas vrojtimit**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

- (a) Gjendja e anijes dhe pajisjeve të saj duhet të ruhet në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje për të siguruar që anija, në të gjitha aspektet, do të mbahet e përshtatshme për të lundruar në det pa sjellë rrezik për vetë anijen ose personat në bord.
- (b) Pas përfundimit të çdo lloj vrojtimi të anijes sipas rregulloreve 7, 8, 9 apo 10, asnjë ndryshim nuk duhet bërë në rregullimet strukturore, makineritë, pajisjet dhe artikuj të tjerë që përfshihen në vrojtimit, pa miratimin e Administratës.
- (c) Kurdoherë që një anije përfshihet në një aksident ose zbulohen defekte që cenojnë sigurinë e saj ose efikasitetin apo tërësinë e pajisjeve të tij për shpëtimin e jetës ose pajisjeve të tjera, kapiteni ose pronari i anijes duhet t'i raportojnë në rastin më të parë Administratës, vrojtuesit të emëruar apo organizatës së njohur përgjegjëse për lëshimin e çertifikatës përkatëse, i cili do të mundësojë fillimin e hetimeve për të përcaktuar nëse nevojitet fillimi i një vrojtimi, siç kërkohet nga rregulloret 7, 8, 9 ose 10. Nëse anija ndodhet në portin e një Qeverie tjetër Kontraktuese, kapiteni ose pronari duhet gjithashtu t'i raportojnë menjëherë autoriteteve përkatëse të Shtetit port dhe vrojtuesi i emëruar apo organizata e njohur duhet të konstatojnë se raportimi është realizuar.

### **Rregullorja 12**

#### **Lëshimi i çertifikatave**

Titulli ekzistues zëvendësohet si më poshtë:

“Lëshimi ose miratimi i çertifikatave”

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

- (a) (i) çertifikata me titull ‘Çertifikata e Sigurisë së Anijeve të Pasagjerëve’ do të lëshohet pas një vrojtimi fillestar ose të përsëritur të anijes së pasagjerëve e cila plotëson kërkesat përkatëse të kapitujve II-1, II-2, III, IV dhe V dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse të këtyre rregulloreve;
- (ii) çertifikata me titull ‘Çertifikata e Ndërtimit e Sigurisë së Anijeve të Mallrave’ do të lëshohet pas një vrojtimi fillestar ose të përsëritur të anijes së mallrave, e cila plotëson kërkesat përkatëse të kapitujve II-1 dhe II-2, (përveç atyre që lidhen me sistemet dhe pajisjet e sigurisë nga zjarri dhe planet e kontrollit të zjarrit), dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse të këtyre

rregulloreve;

(iii) Çertifikata me titull ‘Çertifikata e Pajisjeve të Sigurisë së Anijeve të Mallrave’ do të lëshohet pas një vrojtimi fillestar ose të përsëritur të anijes së mallrave, e cila plotëson kërkesat përkatëse të kapitujve II-1, II-2, III dhe V dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse të këtyre rregulloreve ;

(iv) çertifikata e quajtur ‘Çertifikata e Radios e Sigurisë së Anijeve të Mallrave’ do të lëshohet pas një vrojtimi fillestar ose të përsëritur të anijes së mallrave, e cila plotëson kërkesat përkatëse të kapitullit IV dhe çdo kërkesë tjetër përkatëse të këtyre rregulloreve;

(v) (1) çertifikata me titull ‘Çertifikata e Sigurisë së Anijeve të Mallrave’ mund të lëshohet pas një vrojtimi fillestar ose përsëritës të anijes së mallrave e cila plotëson kërkesat përkatëse të kapitujve II-1, II-2, III, IV dhe V dhe çdo kriter tjetër përkatës të rregulloreve aktuale, si alternativë për çertifikatat e përmendura në paragrafët (a)(ii), (a)(iii) dhe (a)(iv);

(2) kurdoherë që në këtë kapitull i bëhet referencë një ‘Çertifikate të Ndërtimit për Sigurinë e Anijeve të Mallrave’, ‘Çertifikate Pajisjesh për Sigurinë e Anijeve të Mallrave’ ose ‘Çertifikate Radio për Sigurinë e Anijeve të Mallrave’, ajo do të nënkuptojë ‘Çertifikatë Sigurie të Anijeve të Mallrave’, nëse përdoret si një alternativë për këto çertifikata.

(vi) Çertifikata e Sigurisë së Anijeve të Pasagjerëve, Çertifikata e Pajisjeve për Sigurinë e Anijeve të Mallrave, Çertifikata Radio për Sigurinë e Anijeve të Mallrave dhe Çertifikata e Sigurisë së Anijeve të Mallrave, të përmendura në nënparagrafët (i), (iii), (iv) dhe (v), duhet të plotësohen me Regjistrin e Pajisjeve;

(vii) kur për një anije lëshohet një përjashtim, nën dhe në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje, çertifikata me titull ‘Çertifikatë Përjashtimi’ duhet të lëshohet, përveç çertifikatave të përcaktuara në këtë paragraf;

(viii) çertifikatat e përmendura në këtë rregullore duhet të lëshohen ose miratohen ose nga Administrata ose nga ndonjë person ose organizatë e autorizuar prej saj. Në çdo rast, Administrata në fjalë mban përgjegjësi të plotë për çertifikatat.

(b) Qeveritë Kontraktuese nuk mund të lëshojnë çertifikata nën dhe në përputhje me dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1960, 1948 dhe 1929, pas datës kur pranimi i kësaj Konvente nga Qeveria hyn në fuqi.”

### **Rregullorja 13**

#### **Lëshimi i çertifikatës nga një Qeveri tjetër**

Titulli ekzistues zëvendësohet si më poshtë

Lëshimi ose miratimi i çertifikatave nga një Qeveri tjetër

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

“Një Qeveri Kontraktuese, pas kërkesës së Administratës, mund të urdhërojë vrojtimin e një anijeje dhe, nëse bindet që kërkesat e këtyre rregulloreve janë përmbushur, lëshojnë ose autorizojnë lëshimin e çertifikatave për anijen dhe, sipas rastit, miratojnë ose autorizojnë miratimin e çertifikatave për anijen në përputhje me këto rregullore. Çertifikatat e lëshuara në këtë mënyrë duhet të përmbajnë një deklaratë për të vërtetuar se ajo është lëshuar me kërkesën e Qeverisë së Shtetit, flamurin e të cilit ka ose do të ketë anija dhe se ka të njëjtën fuqi dhe njohje si çertifikata e lëshuar sipas rregullores 12.”

### **Rregullorja 14**

#### **Kohëzgjatja e çertifikatave**

Titulli ekzistues zëvendësohet si më poshtë

Kohëzgjatja dhe vlefshmëria e çertifikatave

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

(a) Çertifikata e Sigurisë për Anijet e Pasagjerëve do të lëshohet për një periudhe jo më shumë se 12 muaj. Çertifikata e Ndërtimit për Sigurinë e Anijeve të Mallrave, Çertifikata e Pajisjeve për Sigurinë e Anijeve të Mallrave dhe Çertifikata Radio për Sigurinë e Anijeve të Mallrave duhet të lëshohen për një periudhë kohore që përcaktohet nga Administrata, jo më shumë se pesë vjet. Periudha e vlefshmërisë së Çertifikatës së Përjashtimit nuk duhet të jetë më e gjatë sesa periudha e çertifikatës së cilës i referohet.

- (b) (i) pavarësisht kërkesave të paragrafit (a), kur vrojtimi i përsëritur përfundon brenda tre muajve para datës së skadimit të çertifikatës ekzistuese, çertifikata e re do të jetë e vlefshme nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur, si më poshtë:
- (1) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese;
  - (2) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese;
- (ii) kur vrojtimi i përsëritur përfundon pas datës së skadimit të çertifikatës ekzistuese, çertifikata e re është e vlefshme nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur, si më poshtë:
- (1) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese;
  - (2) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese;
- (iii) kur vrojtimi i përsëritur përfundon pas datës së skadimit të çertifikatës ekzistuese, çertifikata e re është e vlefshme nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur, si më poshtë:
- (1) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur;
  - (2) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur;
- (c) Nëse një çertifikatë e ndryshme nga Çertifikata e Sigurisë së Anijeve të Pasagjerëve lëshohet për një periudhë më të shkurtër se pesë vjet, Administrata mund të zgjasë vlefshmërinë e saj pas datës së skadimit për një periudhë maksimale si specifikuar në paragrafin (a), me kusht që vrojtimit e rregulloreve 8, 9 dhe 12 të zbatueshme në momentin kur lëshohet një çertifikatë për një periudhë 5 vjeçare, të kryhen sipas rastit.
- (d) Nëse një vrojtimi përsëritur ka përfunduar dhe një çertifikatë e re nuk mund të lëshohet ose të vendoset në anije para datës së skadimit të çertifikatës ekzistuese, personi ose organizata e autorizuar nga Administrata mund të miratojë çertifikatën ekzistuese e cila do të pranohet si e vlefshme për një periudhë të mëtejshme që nuk duhet të kalojë 5 muaj nga data e skadimit.
- (e) Nëse një anije në kohën kur skadon një çertifikatë, nuk ndodhet në portin në të cilin do të vëzhgohet, administrata mund të zgjasë periudhën e vlefshmërisë së çertifikatës, por kjo zgjatje jepet vetëm me qëllim për të lejuar anijen të përfundojë udhëtimin në portin në të cilin do të vëzhgohet, dhe vetëm në ato raste kur çmohet si veprimi i duhur dhe i arsyeshëm. Asnjë çertifikatë nuk zgjatet për një periudhë më të gjatë se tre muaj dhe anijes së cilës i jepet një shtesë nuk ka të drejtë, kur mbërrin në portin në të cilin do të vrojtohet në bazë të kësaj shtese, të largohet nga ai port pa marrë një çertifikatë të re. Kur vrojtimi i përsëritur ka përfunduar, çertifikata e re do të jetë e vlefshme si më poshtë:
- (i) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese përpara miratimit të shtyrjes;
  - (ii) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese përpara miratimit të shtyrjes;
- (f) Një çertifikatë e lëshuar për një anije të angazhuar në udhëtime të shkurtra e cila nuk është shtyrë në bazë të dispozitave të mësipërme të kësaj rregulloreje, mund të zgjatet nga administrata për një periudhë faljeje (pa penalitet) deri në një muaj nga data e skadimit të deklaruar. Kur vrojtimi i përsëritur ka përfunduar, çertifikata e re do të jetë e vlefshme si më poshtë:
- (i) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese përpara miratimit të shtyrjes;
  - (ii) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e skadimit të çertifikatës ekzistuese përpara miratimit të shtyrjes;
- (g) Në rrethana të veçanta, siç përcaktohet nga Administrata, çertifikatës së re nuk duhet t'i vendoset data e skadimit të çertifikatës ekzistuese siç përcaktohet nga paragrafët (b)(ii), (e) ose (f). Në këto rrethana, çertifikatat e reja do të jenë të vlefshme si më poshtë:

- (i) për anijet e pasagjerëve, një datë jo më shumë se 12 muaj nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur;
  - (ii) për anijet e mallrave, një datë jo më shumë se pesë vjet nga data e përfundimit të vrojtimit të përsëritur;
- (h) Nëse vrojtimi vjetor, i ndërmjetëm apo periodik kryhet përpara periudhës së parashikuar në rregulloret përkatëse, atëherë:
- (i) data e përvjetorit e treguar në çertifikatën përkatëse mund të ndryshohet vetëm me miratimin e një date jo më shumë se tre muaj nga data në të cilën ka përfunduar vrojtimi;
  - (ii) vrojtimi vjetor, i ndërmjetëm apo periodik pasues i kërkuar nga rregulloret përkatëse, do të kryhet në intervalet e përcaktuara nga ato rregullore, duke përdorur datën e re të përvjetorit;
  - (iii) data e skadimit mund të mbetet e pandryshuar, me kusht që një ose më shumë vrojtme vjetore, të ndërmjetme apo periodike të kryhen në mënyrë që intervalet maksimale midis vrojtmeve të parashikuara në rregulloret përkatëse të mos tejkalohen.
- (i) Një çertifikatë e lëshuar në bazë të rregulloreve 12 ose 13 nuk do të jetë e vlefshme për rastet në vijim:
- (i) nëse vrojtmet dhe inspektimet përkatëse nuk kanë përfunduar brenda periudhës së përcaktuar në rregulloret 7 (a), 8 (a), 9 (a) dhe 10 (a);
  - (ii) nëse çertifikata nuk është miratuar në përputhje me këtë rregullore;
  - (iii) pas transferimit të anijes nën flamurin e një Shteti tjetër. Një çertifikatë e re lëshohet vetëm kur Qeveria që e lëshon, nuk është plotësisht e bindur që anijet janë në përputhje me këtë Konventë. Në rastin e një transferimi midis Qeverive Kontraktuese, nëse kërkohet brenda tre muajve pas kryerjes së transferimit, Qeveria e Shtetit flamurin e të cilit anija ka pasur të drejtë të mbajë më parë duhet, sa më shpejt të jetë e mundur, t'i dërgojë Administratës një kopje të çertifikatave që mbahen nga anija përpara transferimit dhe, nëse është e mundur, kopje të raporteve përkatëse të vrojtimit.”

### **Rregullorja 15**

#### **Formati i çertifikatave**

Titulli ekzistues zëvendësohet si më poshtë:

**“Formati i çertifikatave dhe regjistrave të pajisjeve”**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

“Çertifikatat dhe regjistrat e pajisjeve hartohen në formën që përkon me modelet e dhëna në Shtojcën e Aneksit të kësaj Konvente. Nëse gjuha e përdorur nuk është as anglisht, as frëngjisht, teksti duhet të përmbajë një përkthim në njërën nga këto gjuhë.”

### **Rregullorja 16**

#### **Postimi i çertifikatave**

Titulli ekzistues zëvendësohet si më poshtë:

#### **Disponueshmëria e çertifikatave**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

“Çertifikatat e lëshuara sipas rregullores 12 dhe 13 duhet të jenë lehtësisht të disponueshme në çdo kohë për inspektim në bord”.

### **Rregullorja 19**

#### **Kontrolli**

Teksti ekzistues zëvendësohet me sa vijon:

(a) Çdo anije që ndodhet në portin e një Qeverie tjetër Kontraktuese, i nënshtrohen kontrollit nga zyrtarët e autorizuar sipas rregullave nga Qeveria në fjalë, në masën që kontrolli kufizohet në verifikimin e vlefshmërisë së çertifikatave të lëshuara sipas rregulloreve 12 ose 13.

(b) Këto çertifikata, nëse janë të vlefshme, do të pranohen, përveç rasteve kur ekzistojnë arsye të qarta për të besuar se gjendja e anijes ose pajisjeve të saj nuk përkojnë kryesisht me të dhënat e ndonjë prej çertifikatave ose se anija dhe pajisjet e saj nuk janë në përputhje me

dispozitat e rregullores 11(a) dhe (b).

(c) Në rrethanat e dhëna në paragrafin (b) ose kur një çertifikatë ka skaduar ose nuk është më e vlefshme, zyrtari që kryen kontrollin duhet të ndërmarrë masa për të siguruar që anija të mos lundrojë derisa të jetë në gjendjen e duhur ose të largohet nga porti për të proceduar drejt një kantieri riparimi pa rrezik për anijen ose personat në bord.

(d) Në rast se pas kontrollit nevojitet një ndërhyrje e çfarëdo natyre, zyrtari që kryen kontrollin do të njoftojë menjëherë me shkrim Konsullin ose, në mungesë të tij, përfaqësuesin më të afërt diplomatik të Shtetit flamurin e të cilit mban anija, për të gjitha rrethanat në të cilat ndërhyrja u çmua e nevojshme. Gjithashtu, duhet të njoftohen edhe vrojtuesit e emëruar ose organizatat e njohura përgjegjëse për lëshimin e çertifikatave. Faktet që lidhen me ndërhyrjen duhet t'i raportohen Organizatës.

(e) Autoriteti i Shtetit port në fjalë duhet t'i raportojë në lidhje me të gjitha të dhënat e rëndësishme të anijes autoriteteve të portit pasardhës të qëndrimit të anijes, përveç palëve të përmendura në paragrafin (d), nëse nuk është në gjendje të ndërmarrë veprime siç përcaktohet në paragrafët (c) dhe (d) ose në rast se anija është lejuar të procedojë drejt portit pasardhës.

(f) Gjatë ushtrimit të kontrollit sipas kësaj rregulloreje, duhen bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shmangur që një anije të mbahet apo vonohet parregullsisht. Kur një anije mbahet apo vonohet parregullsisht, ajo ka të drejtë të kompensohet për çdo humbje ose dëm të pësuar.”

## SHTOJCË

### NDRYSHIMET DHE SHITESAT NË SHTOJCËN E ANEKSIT TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR SIGURINË E JETËS NË DET, 1974

Formularët ekzistues të Çertifikatës së Sigurisë së Anijes së Pasagjerëve, Çertifikatës së Ndërtimit të Sigurisë së Anijes së Transportit, Çertifikatës së Pajisjeve të Sigurisë së Anijes së Transportit, Çertifikatës së Radiotelegrafit të Sigurisë së Anijes së Transportit, Çertifikatës së Radiotelefonisë të Sigurisë së Anijes së Transportit dhe Çertifikatës së Përjashtimit të përfshira në shtojcën e aneksit të Konventës zëvendësohen nga format e mëposhtme të çertifikatave dhe regjistrave të pajisjeve.

“Formulari i Çertifikatës së Sigurisë së Anijeve të Pasagjerëve  
ÇERTIFIKATA E SIGURISË SË ANIJEVE TË PASAGJERËVE  
(Kjo Çertifikatë plotësohet me anë të një Regjistrimi të Pajisjeve  
(Formulari P)

(Vula Zyrtare) (Shteti)

për një <sup>1</sup> udhëtim ndërkombëtar  
të shkurtër

Lëshuar në bazë të dispozitave të Konventës Ndërkombëtare për Sigurinë e Jetës në Det, 1974, të ndryshuar nga Protokollin e vitit 1988 që lidhet me të, nën autoritetin e Qeverisë së

(emri i shtetit)

nga

\_\_\_\_\_ (personi ose organizata e autorizuar)

Të dhënat e anijes <sup>2</sup>

Emri i anijes:.....

Numri ose shkronjat dalluese .....

Porti i regjistrimit.....

Tonazhi bruto.....

Zonat e detit në të cilat anija është e çertifikuar për të operuar (rregullorja IV/2)

Numri i IMO-s <sup>3</sup>.....

Data në të cilën është shtruar kili ose anija ishte në një fazë të ngjashme ndërtimi ose, sipas rastit, data kur nisi puna për konvertimin ose ndryshimin në përmasa të mëdha

<sup>1</sup> Fshini, sipas rastit.

<sup>2</sup> Në mënyrë alternative, të dhënat e anijes mund të vendosen horizontalisht në kuti.

<sup>3</sup> Në përputhje me rezolutën A.600 (15)- Skema e Numrit Identifikues IMO të Anijes, ky informacion mund të përfshihet vullnetarisht.

#### KY DOKUMENT VËRTETON SE:

1 Anija është vrojtuar në përputhje me kërkesat e rregullores I/7 të Konventës.

2 Gjatë vrojtimit:

2.1 anija është në përputhje me kërkesat e Konventës në lidhje me:

.1 strukturën, makineritë kryesore dhe ndihmëse, bojlerët dhe bombolat

.2 rregullimet dhe detajet e nënndarjes së papërshkueshme nga uji;

.3 vijat e ngarkesës së nënndarjes në vijim:

Vijat e ngarkesës në nënndarje të caktuara dhe të shënuara në mes të trupit të anijes (rregullorja II-1/13)	Bordi i lirë	E zbatueshme kur hapësirat në të cilat transportohen pasagjerët, përfshijnë hapësirat e mëposhtme alternative
C.1		
C.2		
C.3		

2.2 anija është në përputhje me kërkesat e Konventës në lidhje me mbrojtjen strukturore nga zjarri, sistemet e mbrojtjes nga zjarri dhe pajisjet dhe planet e kontrollit nga zjarri;

2.3 pajisjet e shpëtimit të jetës dhe pajisjet e llojeve të ndryshme të varkave të shpëtimit janë siguruar në përputhje me kërkesat e Konventës.

2.4 anija është e pajisur me pajisjen e lëshimit të litarit të vijës dhe instalimeve radio të përdorura në pajisjet e shpëtimit të jetës në përputhje me kërkesat e Konventës.

2.5 anija është në përputhje me kërkesat e Konventës në lidhje me instalimet radio;

2.6 funksionimi i instalimeve radio të përdorura në pajisjet e shpëtimit të jetës janë në përputhje me kërkesat e Konventës.

2.7 anija është në përputhje me kërkesat e Konventës në lidhje me pajisjet e lundrimit në anije, mjetet e hipjes në anije për pilotët/drejtuesit dhe botimet detare;

2.8 Anija është e pajisur me drita, forma dhe mjete për të dërguar sinjale zanore dhe sinjale rreziku, në përputhje me kërkesat e Konventës dhe Rregulloreve Ndërkombëtare në fuqi për Parandalimin e Përplasjeve në Det;

2.9 në të gjitha aspektet e tjera anija është në përputhje me kërkesat përkatëse të Konventës.

3 Një Çertifikatë Përjashtimi është/nuk është<sup>1</sup> lëshuar.

Kjo çertifikatë është e vlefshme deri më.....

Lëshuar në.....

(Vendi i lëshimit të Çertifikatës)

(Data e lëshimit)(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar që lëshon çertifikatën)

(Vula ose pulla e autoritetit lëshues, sipas rastit)

*Miratimi ku vrojtimi përkatës ka përfunduar dhe kur zbatohet rregullorja I/14 (d)*

Anija plotëson kërkesat përkatëse të Konventës, dhe kjo çertifikatë, në përputhje me rregulloren I/14(d) të Konventës, pranohet si e vlefshme deri më .....

Nënshkroi: .....

(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar)

Vendi: .....

Data: .....

(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)

*Miratimi për të zgjatur vlefshmërinë e çertifikatës deri në mbërritjen në portin e vrojtimit për një periudhë të caktuar faljeje kur zbatohet neni I/14(e) ose I/14(f)*

Kjo çertifikatë, në përputhje me rregulloren I/14(e)/I/14(f)<sup>1</sup> të Konventës, pranohet si e vlefshme deri në.....

Nënshkroi: .....

(Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar)

Vendi: .....

Data: .....

*(Vula ose pulla e autoritetit, sipas rastit)*

1. Fshini, sipas rastit.

---

**REGJISTRI I PAJISJES PËR ÇERTIFIKATËN E SIGURISË SË PASAGJERËVE  
TË ANIJES  
(FORMULARI P)**

Ky Regjistër i bashkëngjitet në mënyrë të përhershme Çertifikatës së Sigurisë së Anijeve të Pasagjerëve

LËSHUAR NË BAZË TË DISPOZITAVE TË KONVENTËS NDËRKOMBËTARE PËR  
SIGURINË E JETËS NË DET, 1974, NDRYSHUAR NGA PROTOKOLLI I VITIT 1988  
QË LIDHET ME TË

1 *Të dhënat e anijes*

Emri i anijes: .....

Numri ose shkronjat dalluese.....

numri i pasagjerëve për të cilin është çertifikuar .....

Numri minimal i personave që iu është kërkuar kualifikim për të operuar instalimet radio

2 Të dhëna për pajisjet e shpëtimit të jetës

1 Numri total i personave për të cilët janë siguruar pajisje të shpëtimit të jetës		Ana e portit	Ana e djathtë e përparme
2	Numri total i varkave të shpëtimit		
2.1	Numri i përgjithshëm i personave të akomoduar në to		
2.2	Numri i varkave të shpëtimit pjesërisht të mbyllura (rregullorja III/42)		
2.3	Numri i varkave të shpëtimit pjesërisht të vetë-qëndrueshme (rregullorja III/43)		
2.4	Numri i varkave të shpëtimit totalisht të mbyllura (rregullorja III/44)		
2.5	Varka të tjera shpëtimi		
2.5.1	Numri		
2.5.2	Tipi		
3	Numri i motorëve të shpëtimit të përfshirë në varkat totale të shpëtimit të treguara më lart		
3.1	Numri i varkave të shpëtimit të pajisura me dritat e kërkimit		
4	Numri i varkave të shpëtimit		
4.1	Numri i varkave të përfshira në totalin e varkave të treguara më lart		
5	Varkat e shpëtimit		
5.1	Ato për të cilat pajisjet e miratuara të lëshimit janë kërkuar		
5.1.1	Numri i varkave të shpëtimit		
5.1.2	Numri i personave të akomoduar në to		
5.2	Ato për të cilat pajisjet e miratuara të lëshimit janë		
5.2.1	Numri i varkave të shpëtimit		
5.2.2	Numri i personave të akomoduar në to		
6	Aparati i lundrimit		
6.1	Numri i aparateve		
6.2	Numri i personave që mund të mbahen		
7	Numri i gomave të shpëtimit		
8	Numri i jelekëve të shpëtimit		
9	Kostume zhytjeje		
9.1	Numri i përgjithshëm		
9.2	Numri i kostumeve që plotësojnë kërkesat për Jelekë shpëtimi		
10	Numri i ndihmave mbrojtëse termike 1		
11	Instalimet radio të përdorura në pajisjet e shpëtimit të jetës		
11.1	Numri i transponderëve të radarit		
11.2	Numri i aparateve radiotelefonike VHF me dy drejtime		



<sup>1</sup> Duke përjashtuar ato të kërkuara nga rregulloret III/38.5.1.24, III/41.8.31 dhe III/47.2.213.

### 3 Detajet e objekteve të radios

Artikulli	Dispozita aktuale
1 Sistemet parësore	
1.1 Instalimet radio VHF	
1.1.1 Koduesi DSC	
1.1.2 Marrësi i vëzhgimit	
1.1.3 Radio telefonia	
1.2 Instalimet radio MF	
1.2.1 Koduesi DSC	
1.2.2 Marrësi i vëzhgimit	
1.2.3 Radio telefonia	
1.3 Instalimet radio MF/HF	
1.3.1 Koduesi DSC	
1.3.2 Marrësi i vëzhgimit	
1.3.3 Radio telefonia	
1.3.4 Radio telefonia me printim të drejtpërdrejtë	
1.4 Stacioni tokësor i anijeve INMARSAT	
2 Mjete dytësore njoftimi	
3 Objekte për marrjen e informacionit të sigurt detar	
3.1 Marrësi NAVTEX	
3.2 Marrësi EGC	
3.3 Marrësi radiotelefonik me printim të drejtpërdrejtë HF	
4 Sateliti EPIRB	
4.1 COSPAS-SARSAT	
4.2 INMARSAT	
5 VHF EPIRB	
6 Transponderi i radarit të anijes	
7. Marrësi i vëzhgimit të frekuencës së sinjalizimit radiotelefonik për 2,182 kHz 2	
8. Aparati për gjenerimin e sinjalit të alarmit radiotelefonik për 2,182 kHz 3	

